



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI STOMATOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR**

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN, ANËTARËSIMIN DHE LIÇENSIMIN

1. Bazimi

Kjo Rregullore është hartuar në mbështetje dhe për zbatim të Ligjit 127/2014, datë 02.10.2014 "Për Urdhrin e Stomatologut" (U.S.SH.), neni 3 dhe 4, të Ligjit 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" neni 27 dhe 32, të Ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë" neni 12, si dhe të Statutit të Urdhrit të Stomatologut.

2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është vendosja e kriterëve dhe normave për anëtarësimin, regjistrimin dhe dhëniën e liçensës për ushtrimin individual të profesionit të stomatologut.

3. Dispozita të Përgjithshme

Urdhri Stomatologut të Shqipërisë krijon dhe administron Regjistrin Themeltar Rajonal dhe Kombëtar të anëtarëve të Urdhrit.

Proçesi i krijimit dhe administrimit të Regjistrit Themeltar Rajonal dhe Kombëtar të stomatologëve qëndron në themel të misionit dhe të veprimtarive të Urdhrit.

Aparati Qëndror është struktura bazë që vendos për anëtarësimin në Urdhrin e Stomatologut dhe e finalizon atë me aktin e regjistrimit dhe dhëniën e liçensës për ushtrimin individual të profesionit.

Aparati Qëndror i Urdhrit Stomatologut është autoriteti përgjegjës për krijimin dhe mirëadministrimin e Regjistrit Themeltar Kombëtar, si dhe mirëadministrimin e atij Rajonal. Për këtë qëllim, pranë Aparatit Qëndror të Urdhrit të Stomatologut funksionon Komisioni i Regjistrim-Liçensimit, Etikës dhe Standardeve të Edukimit dhe Ushtrimit Profesional.

4. Regjistri

- Regjistri Themeltar dhe vendimmarrja kush hyn në Regjistër, kush mbetet dhe kush hiqet nga Regjistri është në themel të veprimtarisë së Urdhrit të Stomatologut.

- Regjistri vë në dukje jo vetëm rritjen numerike dhe lëvizjen mekanike të mjekëve, por ai pasqyron edhe ecurinë e formimit dhe edukimit etiko-profesional e shkencor të tyre.
- Regjistri i mjekëve stomatolog i mirëadministruar dhe i përditësuar rregullisht, merr rol të rëndësishëm për evidentimin dhe rivlerësimin e standardeve dhe performancës profesionale, si dhe për procesin e vendimmarrjes për rinovimin e liçensës për ushtrimin individual të profesionit.

5. Regjistrimi dhe Anëtarësimi

Akti i vendimmarrjes për anëtarësim, ri-anëtarësim, regjistrim, ç'regjistrim, dhënien e liçensës për ushtrimin individual të profesionit dhe heqjen e saj bëhet në përputhje me kriteret dhe dokumentat e vendosura në dispozitat e Statutit të USSH-së dhe të kësaj Rregulloreje.

5.1 Dokumentacioni që nevojitet për praktikën profesionale (Stazhi tre mujor)

a. Kërkes me shkrim (vetëdeklarim) për regjistrim në praktikën profesionale dhe pas kryerjes së saj, hyrjen në provimin e shtetit (që do të zhvillohet te AKP)

b. formulari i aplikimit

c. Fotokopje e kartës së identitetit

d. fotokopje e noterizuar e diplomës, listës së notave dhe suplementit (në mungesë të tyre, për periudhën tre mujore të stazhit, mund të mjaftohemi edhe me vërtetimin e fakultetit përkatës që mjeku në fjalë i ka mbaruar detyrimet e tij akademike)

e. raporti mjeko-ligjor

f. dëshmi penaliteti dhe vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale

g. Vetdeklarim ose prokurë nga stomatologu që do të udhëheqi/mbikqyrë stazhin e të sapodiplomuarit pranë institucionit të tij. Kësaj prokure i bashkangjitet fotokopja e liçensës së stomatologut mbikqyrës (me një përvojë mbi 3 vjet) dhe ekstrakti i QKR së tij. Në rastin e kryerjes së praktikës profesionale në një institucion shtetëror, do të nevojitet vërtetim nga drejtoria përkatëse.

h. Mandat pagesa e hapjes së dosjes nga USSH dhe mandatpagesa e provimit të shtetit.

i. Libreza profesionale e stazhit

j. Raportimi financiar

5.2 Dokumentacioni që nevojitet për liçensim për hër të parë

Për t'u regjistruar dhe anëtarësuar në Urdhrin e Stomatologut, aplikanti duhet të paraqesë këto dokumenta.

- a. Të jenë shtetas shqiptarë dhe të paraqesin fotokopjen e Pasaportës ose Kartës së Identiteti.
- b. Kërkesën për anëtarësim, në të cilën shprehet se njih Statutin e UMSH, Betimin e Mjekut dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike dhe zotohet se do t'i respektojë ato me përpikmëri.
- c. Curriculum Vitae profesionale
- d. Të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit dhe Regjistrimit
- e. Dokumentin zyrtar, i cili vërteton studimet, kualifikimet, specializimet e kryera dhe titujt e fituar (pra të kenë diplomën e stomatologut, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, i njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin. Te USSH të paraqiten fotokopja e noterizuar e diplomes, suplementi dhe lista notave).
- f. Referencë të protokolluar nga organi drejtues i institucionit shëndetësor apo social-shëndetësor ku shërben apo ku ka shërbyer mbi performancën dhe sjelljen profesionale sipas formatit tip i cili përgatitet nga Urdhri i Stomatologut (kjo vlen për stomatologët që ushtrojnë profesionin e tyre në sistemin publik).
- g. Dëshmi penalteti nga organi përkatës (vërtetim nga gjykata dhe prokuroria). Në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.
- h. të njohin dhe të zotohen me shkrim që do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutin, Kodin Etik dhe Deontologjik Stomatologjik.
- i. Raporti Mjeko Ligjor.
- j. Vërtetim nga QKEV që është regjistruar pranë këtij institucioni.
- k. 3 foto të formatit 3x4
- l. Raportimi financiar

~5.2 Dokumentacioni që nevojitet për Riliçensimin e mjekut stomatolog (ky është dokumentacioni plotësues, pasi dosja ka të gjithë dokumentacionin që paraqitet në pikat 5.1 dhe 5.2).

- a) Curriculum Vitae profesionale
- b) Të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit dhe Regjistrimit
- c) Dokumentin zyrtar, i cili vërteton kualifikimet, specializimet e kryera dhe titujt e fituar .
- d) Vërtetim nga QKEV që plotëson kreditet e nevojshme për tu ri liçensuar
- e) Ekstrakti QKR-ës ose Librezë Pune
- f) 2 foto të formatit 3x4cm
- g) Raportimi financiar (USSH)

5.4 Mjeku stomatolog, shtetas i huaj që të ushtrojë profesionin si resident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, i duhet edhe:

- a) Leja e qëndrimit dhe leja e punës në Republikën e Shqipërisë (për ata që janë rezidentë në Shqipëri).
- b) Çertifikatë e sjelljes së mirë profesionale (Good Standing Certificate) nga Urdhri/Dhoma apo Shoqata e Mjekëve të vendit të vet ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe

se gjatë ushtrimit të profesionit nuk ka asnjë masë disiplinore kundrejt tij/saj.

- c) Konvalidimi (njësimi) i diplomës dhe certifikatave të specializimeve që ka kryer prej tij/saj të përkthyer dhe të noterizuara.
- d) Dëshmi Penaliteti ose dokument tjetër zyrtar i lëshuar nga organet përkatëse të vendit nga ku vjen, ku të vërtetohet se nuk ka vuajtje dënimi (e përkthyer dhe e noterizuar).
- e) Të rekomandohet nga një specialist vendas i të njëjtës fushe, anëtar i Urdhrit të Stomatologëve.
- f) Stomatologu i huaj rezident në Shqipëri të njohë Gjuhën Shqipe, dhe të ketë aftësi komunikimi në Shqip (njohja e gjuhës shqipe, e vërtetuar me dëshmi nga një autoritet i licencuar nga shteti). Per stomatologun jo rezident detyrimisht të punoj me përkthyes.
- g) Raporti Mjeko Ligjor.
- h) Vërtetim nga QKEV që plotëson kreditet e nevojshme për tu ri licencuar
- i) Ekstrakti QKR-ës ose Librezë Pune (në rast të ri Licensimit)
- j) 2 foto të formatit 3x4
- k) Curriculum Vitae profesionale
- l) fotokopjen e Pasaportës ose Kartës se Identiteti.
- m) Kërkesën për anëtarësim, në të cilën shprehet se njeh Statutin e UMSH, Betimin e Mjekut dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike dhe zotohet se do t'i respektojë ato me përpikmëri.
- n) Raportimi financiar

5.5 Ndhmës stomatologu për t'u regjistruar në Urdhrin e Stomatologut duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të ketë një diplomë për ndihmësstomatolog, të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- b) Dëshmi penaliteti nga organi përkatës, dhe (vërtetim nga gjykata dhe prokuroria). Në momentin e kërkesës për anëtarësim, të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale.
- c) Kërkesën për anëtarësim, në të cilën zotohet se do t'i njohe dhe respektoje kerkesat dhe legjislacionin e USSH, Statutin e UMSH, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Stomatologjike me përpikmëri.
- d) 2 foto të formatit 3x4
- e) Raporti Mjeko Ligjor.
- f) Vërtetim nga QKEV që plotëson kreditet e nevojshme për tu ri licencuar
- g) Ekstrakti QKR-ës ose Librezë Pune (në rast të ri Licensimit)
- h) fotokopjen e Pasaportës ose Kartës se Identiteti.
- i) Curriculum Vitae profesionale
- k) Të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit dhe Regjistrimit
- l) raportimi financiar

6.1 Sekretari Rajonal i Urdhrit pranon dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti dhe pasi sigurohet se është në përputhje me kërkesat e mësipërme e paraqet për shqyrtim në Komisionin e Licensimit.

6.2 Regjistrimi, anëtarësimi dhe lëshimi i licensës për ushtrimin individual të profesionit bëhet pasi miratohet si dosje e rregullt nga Komisionin e Licensimit dhe me pas mer vendimin e licensimit nga Kryesia e Këshillit Rajonal.

Për këtë qëllim:

- a- Mbledhja e komisionit të licensimit (KL) për të shqyrtuar dokumentacionin e dosjes, bëhet çdo të premtë; ku shqyrtohet kërkesat e paraqitura.
- b- KL mban një Protokoll të veçantë ku dokumentohet hollësisht zhvillimi i mbledhjes. Në përfundim, protokollin nënshkruhet nga pjesëmarrësit;
- c- Vendimi i Kryesisë për anëtarësimin dhe dhënien e Liçensës për ushtrimin individual të profesionit formulohet si dokument i veçantë me numrin përkatës, i cili firmoset nga Presidenti i Këshillit Rajonal dhe nga ai Kombëtar. Ai protokollohet dhe mbahet në Arkivin e Këshillit Rajonal.

6.3 Në mbledhjet e rradhës, Këshilli Rajonal informohet për anëtarësimet e reja.

7. Liçensa (leja) për ushtrimin individual të profesionit dhe përsëritja e saj *(liçensim-ri-liçensim)*

7.1 Urdhri i Stomatologëve ka për detyrë të kryej akreditimin, ri-akreditimin, liçensimin dhe ri-liçensimin e stomatologëve dhe profesionistëve të tjerë të lartë, anëtarë të Urdhrit të Stomatologëve, që ushtrojnë profesionin në sistemin shëndetësor mbi bazën e kritereve të matjes, vlerësimit dhe rivlerësimit periodik të kompetencës, performancës dhe sjelljes profesionale.

7.2 Pajisja me liçensë (leje) për ushtrimin individual të profesionit është normë e detyrueshme për çdo stomatolog apo ndihmësstomatolog, anëtarë të Urdhrit të Stomatologëve.

7.3 Ri-vlerësimi, ri-akreditimi dhe ri-liçensimi periodik është mënyra për të përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor, për të mbrojtur publikun nga kequshtrimi i stomatologjisë dhe për të siguruar pacientin se poseduesi i liçensës është kompetent dhe i përmbush standardet etike profesionale të parashikuara në ligjet dhe rregullat për kujdesin shëndetësor.

7.4 Në vartësi të kategorive dhe të nivelit të profesionistëve që e përfitojnë, janë tre kategori apo nivele të liçensës:

- a. *Çertifikata provizore për ushtrimin e profesionit ndën vëzhgim (mbikqyrje);*
- b. *Liçensa bazë për ushtrim të pavarur (pa mbikqyrje) të profesionit;*
- c. *Ri-liçensimi (përsëritja e liçensës).*

7.5 Çertifikata (leja) provizore për ushtrimin e profesionit ndën mbikqyrje lëshohet në bazë të rregullores së posaçme "Për Organizimin e praktikës profesionale për mjekun stomatolog në Republikën e Shqipërisë", e cila miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar. Kjo rregullore trajton rregullat e anëtarësimin provizor dhe lëshimit të certifikatës provizore të profesionistit ndën mbikqyrje.

7.6 Liçensa bazë për ushtrim të pavarur të profesionit (pa mbikqyrje) lëshohet për:

a- Stomatologët dhe ndihmësstomatologët, anëtarë të Urdhrit të Stomatologëve, të cilët aktualisht janë të regjistruar, anëtarësuar dhe ushtrojnë profesionin, por nuk janë ende të liçensuar;

7.7 Stomatologët dhe ndihmësstomatologët, të cilët kanë kryer praktikën profesionale dhe kanë kaluar provimin e shtetit. Liçensimi i tyre bëhet pasi të jetë kryer regjistrimi dhe anëtarësimi definitiv në U.S.SH., në përputhje me dispozitat e Statutit dhe të kësaj Rregulloreje pranë Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar.

7.8 Ri-liçensimi është përsëritja e liçensës në vartësi të rezultateve të arritura në procesin e ri-vlerësimit, ri-akreditimit profesional që kryhet me skadimin e liçensës bazë dhe ruajtja e së drejtës për vazhdimin e mëtejshëm të ushtrimit të profesionit.

7.9 Proçesi i ri-akreditimit dhe ri-liçensimi kryhet çdo 5 (pesë) vjet.

7.10 Ri-anëtarësimi dhe rifitimi i së drejtës për ushtrimin e profesionit

Stomatologu dhe ndihmësstomatologu i cili për çfarëdo arsyeje, nuk ka ushtruar profesionin për një periudhë mbi 5 (pesë) vjet, për të rifituar të drejtën për të ushtruar profesionin duhet:

- a) Të kryej procedurat e ri-regjistrimit dhe ri-anëtarësimit në U.S.SH., në përputhje me këtë rregullore si dhe me Statutin e U.S.SH.
- b) Ti nënshtrohet praktikës profesionale të mbikqyruar për një periudhë kohore 6 (gjashtë) muaj. Në përfundim të pajiset me dokumentin zyrtar ku të konfirmohet aftësia për të ushtruar profesionin si i pavarur.
- c) Të pajiset me Liçensë për ushtrimin individual të profesionit.

8. Pezullimi dhe heqja e përhershme e Liçensës

8.1 Stomatologut apo ndihmësstomatologët, anëtar i Urdhrit të Stomatologëve i pezullohet liçensa kur:

- Ka një vendim të formës së prerë të Komisionit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Stomatologëve;
- Është duke vuajtur një dënim penal me heqje lirie;
- Nuk shlyen kuotizacionet brenda afateve të parashikuara në Statutin e Urdhrit të Stomatologëve;
- Nuk plotëson detyrimin e pjesëmarrjes në EVM apo nuk fiton kreditet e detyrueshme;
- Nuk kalon provimet apo testet e domosdoshme të caktuara për një detyrim kualifikimi apo praktike profesionale shtesë të parashikuara me një vendim disiplinor të formës së prerë nga Komisioni Disiplinor Profesional i Urdhrit të Stomatologëve.

8.2 Për periudhën e pezullimit të përkohshëm të liçensës, profesionisti ruan regjistrimin dhe anëtarësimin në Urdhrin e Stomatologëve, në përputhje me dispozitat statutorë për anëtarët e Urdhrit, por pa gëzuar të drejtën për të ushtruar profesionin.

8.3 Heqja e përhershme e liçensës në Urdhrin e Stomatologëve bëhet vetëm me vendim gjyqësor të formës së prerë, kur mjeku është përgjegjës për kequshtrim të profesionit që rezulton me një dëmtim të përhershëm shëndetësor ose me vdekjen e të sëmurit.

8.4 Veprimet proceduriale për pezullimin e përkohshëm apo heqjen e përhershme të liçensës, kryhen në mbështetje dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, si dhe në dispozitat e Statutit, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe të Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Stomatologëve.

9. Formularët Standardë

Proçesi i anëtarësimit dhe i regjistrimit përmban formularë standardë:

- A. **FORMULARI I REGJISTRIMIT** i cili përmban kërkesat që pasqyrojnë të dhënat profesionale të mjekut kandidat.
- B. **FORMULARI I VETDEKLARIMIT** është dokumenti që i kërkohet mjekut për ta paraqitur me përgjegjësi personale, për efekt të ripërtëritjes së liçensës së ushtrimit individual të profesionit. Në këtë dokument, mjeku pasqyron të gjithë veprimtarinë e tij profesionale për periudhën e përfshirë midis dy Liçensave (lejeve) (pjesëmarrjen në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, kualifikime e specializime të tjera, vlerësime për veprimtarinë dhe sjelljen e tij profesionale, masa disiplinore etj).
- C. **Formati Tip i "ÇERTIFIKATËS SË SJELLJES SË MIRË PROFESIONALE"** që lëshohet nga Drejtoria e Institucionit Shëndetësor apo social-shëndetësor.
- D. **Formati Tip: "LIÇENSA PËR USHTRIMIN INDIVIDUAL TË PROFESIONIT PËR STOMATOLOGË"**
- E. **Formati Tip: "ÇERTIFIKATË E PRAKTIKANTIT"**
- F. **FORMULARI I APLIKIMIT** për regjistrimin dhe pranimin në provimin e shtetit.
- G. **FORMULARI PER KERKESE REGJISTRIMI PROVIZOR, LICENSIMI DHE RILICENSIMI**
- H. **Formati i raportimit financiar**
- I. **Formati i kartës së anëtarësimit për praktikantin dhe mjekun stomatolog.**

10. Administrimi dhe përditesimi i Regjistrimit dhe dosjes personale të stomatologut në Këshillin Rajonal

- Dosja Personale e stomatologut, përmban të gjithë dokumentat rreth tij. Dosjes i vihet numri përkatës i USSH (ose trashëgohet ai i UMSH) dhe ruhet në kartotekën e Këshillit Rajonal. Dosjet e mjekëve që hiqen nga Regjistri (ç'regjistrohen) ruhen në kartotekë në ndarje të posaçme.
- Regjistri Rajonal mbahet në formë manuale dhe të kompjuterizuar.
- Dosjet vendosen në rafte sipas rendit alfabetik ku shënohet inicialja e mbiemrit të Stomatologut. (Ato mund të vendosen edhe sipas institucioneve duke respektuar rendin alfabetik).

- Stomatologu i anëtarësuar pajiset me kartën të anëtarit të USSH-së (**ID CARD**), e cila mban numrin e dosjes personale.
- Formularët e regjistrimit dhe të liçensimeve të reja, bashkë me të dhënat e përditësimit dhe ri-vlerësimit periodik, në fund të çdo 4 mujori dërgohen në Aparatin Qëndror të Këshillit Kombëtar për t'u pasqyruar në Regjistrin Themeltar Kombëtar.
- Kur stomatologu largohet dhe punësohet në një rajon tjetër, dosja e tij duke përfshirë dhe informacionin për pagesën e kuotizacioneve, transferohet në rajonin përkatës ku merret në administrim.
- Stomatologu që largohet është i detyruar të njoftojë Keshillin Rajonal në të cilin ka qenë i regjistruar të paktën 15 ditë para largimit. Rajoni pritës çdo 4 muaj informon Aparatin Qëndror të Këshillit Kombëtar për të bërë ndryshimet përkatëse në Regjistrin Themeltar Kombëtar.

11. Administrimi i Regjistrit dhe dokumentave të mjekut në Aparatin Qëndror të Këshillit Kombëtar

- Bordi i Regjistrim-Liçensimit, Etikës dhe Standardeve të Edukimit dhe Ushtrimit Profesional pranë Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar kryen përditësimin periodik të Regjistrit Kombëtar me të dhënat që dërgohen nga Këshillat Rajonale. Regjistri Kombëtar ruhet në Formën e Kompjuterizuar (Database).
- Stomatologët e regjistruar në Regjistrin Kombëtar do të kenë numrin e tyre në database.
- Nëpërmjet faqes së USSH në internet (website) – www._____ Regjistri është i hapur edhe për publikun.
- Komisioni i Regjistrim-Liçensimit, Etikës dhe Standardeve të Edukimit dhe Ushtrimit Profesional pranë Aparatit Qëndror të Këshillit Kombëtar kryen edhe:
 - a. Monitorimin e procesit të regjistrimit dhe mirëadministrimit të Regjistrit në nivel rajoni.
 - b. Raportimin në mënyrë periodike, 4 mujore dhe vjetore në Këshillin Kombëtar mbi Regjistrin Kombëtar ku detajohen ndryshimet, të dhënat statistikore dhe informacione të tjera problemore në lidhje me regjistrimin.
 - c. Ruajtjen dhe përditësimin në kopje CD të Regjistrit Kombëtar.
 - d. Në bashkëpunim me Këshillat Rajonale merr takime me institucione publike e private për të verifikuar dhe kontrolluar të dhënat profesionale të stomatologëve.

12. Ankimi për refuzimin e anëtarësimit

Ndaj vendimit që refuzon kërkesën për anëtarësim dhe regjistrim në Urdhrin e Stomatologëve, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar në përputhje me dispozitat që përcaktohen në Statutin e Urdhrit të Stomatologëve.

13. Ndërprerja e anëtarësimit (Ç'regjistrimi)

Për ndërprerjen e anëtarësimit në Urdhrin e Stomatologëve (ç'regjistrimin) dhe heqjen e lejes individuale për ushtrimin e profesionit zbatohen dispozitat e Statutit të Urdhrit të Stomatologëve dhe të kësaj Rregulloreje.

14. Tarifat

Akti i anëtarësimit dhe regjistrimit, liçensa për ushtrimin individual të profesionit, vërtetimet e identitetit të anëtarit/es, vërtetimet për jashtë shtetit (good standing certificate), si dhe dokumentat e tjera lëshohen kundrejt tarifave të veçanta, të cilat përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Stomatologëve (tarifat janë përcaktuar nga mbledhja e dt.5.8.2015 të keshilli kombetare, nr vendimi 7).

15. Njoftimi për anëtarët

Çdo Këshill Rajonal brenda juridiksionit të vet ka përgjegjësinë për t'i njohur anëtarët e tij me përmbajtjen e kësaj Rregulloreje. Kësaj Rregulloreje i bashkëlidhet formularët standart që paraqiten te pika 9, e kësaj rregullore.